

Qani Nuhiu, MA¹

UDC:
323.1:329.015]:321.7

**ROLI I DIALOGUT POLITIK NË NDËRTIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DEMOKRACISË**

**УЛОГАТА НА ПОЛИТИЧКИОТ ДИЈАЛОГ ВО ГРАДЕЊЕТО
И ФУНКЦИОНИРАЊЕТО НА ДЕМОКРАТИЈАТА**

**ROLE OF POLITICAL DIALOGUE IN THE CONSTRUCTION
AND FUNCTIONING OF DEMOCRACY**

Abstract

This study will provide a general definition of dialogue and specifically of political dialogue; the role and impact of the political dialogue in building a democracy and regulating the relations within a society as well as internal relations between institutions, political parties, civil society and many other societal structures; various features of political dialogue; the role of scientific, cultural, political and civil sector elites in cultivating political dialogue; the role of political parties and media in forming a culture suitable for the development of a political dialogue; the political dialogue as a determining factor in cultivating harmony in society, consolidating it and building and advancing democracy.

Democracy as a form of social and institutional organization, as a way of regulating relations in society, but also as a form of government, is not an act but a continuous and complex long-term process that depends on many factors, dialogue being a crucial one. A democratic society cannot exist unless dialogue exists. Democracy is often faced with serious social and political challenges that can only be overcome

¹ University of Tetova, Faculty of Law
e-mail: qani.nuhiu@unite.edu.mk

through the dialogue between factors that are part or have an impact on the political and social processes in general. The dialogue, its practice and the advancement of the culture of dialogue in society are determined by many factors, such as political, cultural, traditional, historical, sociological ones, etc. Yet, generally speaking, among all the values, parameters and principles upon which democratic systems are based, social dialogue, as a part of the governance mechanism within society, is a necessary condition of the building and functioning of democracy.

Key words: democracy, dialogue, social organization, social tolerance, democratic governance.

Hyrje

Komunikimi në mes të njerëzve paraqet një nga karakteristikat më të para të njerëzimit dhe nevojat themelore njerëzore, pasi njerëzit çdoherë kanë nevojë praktike edhe shpirtërore për të komunikuar njëri me tjetrin. Motivet për biseduar njerëzit njëri me tjetrin janë të determinuar nga vetë natyra e nevojat personale të njeriut, sepse qenia njerëzore nuk është e përkryer, prandaj ai qenien e vetë e plotëson dhe e kultivon vetëm në komunikim dhe në bashkëjetesë me njerëzit tjerë. Biseda ose dialogu është trajtë dhe formë e komunikimit ndër njerëzor individual apo në mes të grupeve shoqërore dhe si e tillë paraqet dukuri më të përhapur shoqërore, kurse më vonë edhe politike dhe është forma më e përhapur dhe më bazike e veprimit ndër njerëzor. Ai gjithashtu është një ndër dukuritë më të hershme të shoqërisë njerëzore. Pra, dialogu (bisedimi, bashkëbisedimi) paraqet mënyrën themelore të komunikimit individual dhe shoqëror. Ndërsa, në jetën politike dialogu është një ndër gurëthemelet e organizimit të shoqërisë dhe të funksionimit të shtetit dhe institucioneve.

1. Nocioni i dialogut

Dialogu së pari është mënyrë e të menduarit, sjelljes, e të vepruarit dhe mënyrë jetese. Nocioni “dialog” vjen nga greqishtja e vjetër, konkretisht nga fjala “dialogos” që d.m.th. bisedë (ose fjalim) në mes të dy palëve (subjekteve); ndryshe, nënkupton edhe formë letrare artistike në filozofinë antike, të cilën e kanë krijuar SOFISTËT, si Sokrati e në veçanti Platoni², paraqet bisedën me të folur apo më të shkruar në mes të dy apo më tepër personave.

² Милан Вујаклија “ЛЕКСИКОН СТРАНИХ РЕЧИ И ИЗРАЗА”, ПРОСВЕТА, БЕОГРАД, 1992, стр. 217;

Dialogu, që nga krijimi i shoqërisë njerëzore, e në veçanti nga fillimi i organizimit politik të shoqërisë, parqet një nga komponentët kryesore të funksionimit të shoqërisë dhe njerëzimit në përgjithësi. Si i tillë, dialogu politik është edhe komponentë shumë e rëndësishme e kulturës dhe jetës politike.

Nuk paramendohet dot se mund të kemi shoqëri të konsoliduar dhe institucione funksionale pa nivel të lartë të kulturës politike. Kurse në veprimtarinë politike, si pjesë të kulturës politike është e nevojshme që të praktikohen edhe mekanizmat në vijim, si: **dialogu, komunikimi politik, kompromisi, toleranca, konsensusi, kritika dhe kontrolli ndaj institucioneve.**

Dialogu si mënyrë e të menduarit e të vepruarit në politikë, por edhe të të jetuarit, në veçanti është i nevojshëm të praktikohet tek **“demokracitë më të reja”**³, një pjesë e të cilave akoma janë në fazën e demokratizimit. Ndërkaq “Në kuptimin e tij themelor, demokratizimi nënkupton procesin ose, thënë më mirë, proceset nëpërmjet të cilave një regjim politik shndërrohet në demokratik pas njëfarë lloji autokracie ose bëhet demokratik duke i falënderuar reformave të brendshme”.⁴

Dialogu është akti i lartësuar i të menduarit politik, veprimit dhe të sjelljes, dhe mënyra më e mirë e komunikimit politik. Formula “nuk ka vepra pa fjalë” është masë për sjelljen e njeriut në jetën e përbashkët politike.⁵ Për jetë të suksesshme në bashkësinë njerëzore e politike është e nevojshme të respektohet rregulli se pas fjalëve (të deklaruarit) gjithnjë duhet të qëndrojnë veprat ose punët konkrete të premtuara.

Gjithashtu **“Grekët Antik** kanë konsideruar se **forca dhe dhuna** janë mece dhe për këtë shkak nuk duhet të kenë vend në politikë. Kur në politikë nuk bisedohet (nuk udhëhiqet dialog), atëherë urdhërohet ose përdoret forca dhe dhuna. Edhe problemi më i rëndë i përbashkët mund të zgjidhet me dialog e bisedime. Dialogu i përmirëson mendimet tona për vetë ne dhe për të tjerët, gabimet dhe paragjykimet tona, kufizimet tona dhe gabimet e mundshme. Aty ku në politikë nuk bisedohet,

³ Me nocionin “demokracitë më të reja” nënkuptohen sistemet pluraliste dhe demokratike të vendosura në shtetet ish komuniste të Evropës Qendrore dhe Juglindore.

⁴ “ENCIKLOPEDIJA DRUŠTVENIH NAUKA”, TOM 1 (A-M)/ priredili Adam Kuper i Džesika Kuper, Izdavač SLUŽBENI GLASNIK, Beograd, 2009, f. 121;

⁵ Dr Čedomir Čupić POLITIČKA KULTURA I MEDIJI, FPN | Godišnjak 2009 | II DEO: Novinarstvo, komunikologija, kulturologija; str. 339-351; Beograd, 2009; str. 341.

thellohen problemet, hapen konflikte, zgjerohen krizat, dhe, në fund, udhëhiqen luftëra”.⁶

Gatishmëria e shoqërisë për të krijuar kulturë të dialogut shkon krahas me demokratizimin e shoqërisë, e cila “i referohet kalimit nga autoritarizmi te demokracia liberale. Karakteristikat më të rëndësishme të këtij procesi janë lejimi i lirive bazë dhe veçanërisht i të drejtave politike, vendosja e zgjedhjeve popullore dhe konkurruese dhe (veçanërisht në regjimet postkomuniste), hyrja e reformave të tregut”.⁷

Për të qenë mjaftueshëm i përgatitur për takim dhe bisedë me tjerët, donë të thotë të jesh i përgatitur që të dëgjosh edhe mendim ndryshe nga mendimi yt, me pikëpamje tjera dhe të ballafaqohesh me argumente të reja. Ky është një nga kushtet të cilat janë të nevojshme për demokracinë e cila ka të bëjë “me sistemin politik dhe me aspiratat politike”.⁸

Dialogu në një farë mënyrë është edhe kreativitet, pasi në dialog me tjetrin (përballë nesh) futemi në bisedë me një lloj qëndrimesh dhe argumentesh, kurse nga biseda mund të dalim me argumente më të ndryshme dhe zgjidhje më të mira nga ajo që e paramendonim para se të futemi në dialog. Pra, dialogu na mundëson që të arrihet deri tek e vërteta dhe qëndrimi i përbashkët me bashkëbiseduesin.

Dialogu është bazamenti kryesor në komunikimin politik dhe një nga shtyllat më të rëndësishme të kulturës politike. Nuk mund të ekzistojë kulturë politike demokratike pa dialog. Një sistem demokratik i konsoliduar dhe i rregulluar mirë, nuk mund as të ndërtohet, e aq më pak të funksionojë, pa dialog. Premisa kryesore e dialogut në politikë është: që të dëgjohet me kujdes tjetri dhe ndaj tjetrit të tregohet respekt dhe të pranohet si i barabartë. Nuk mund të ketë dialog ndërmjet të pabarabartëve.

Personi që ka prirje për dialog është i hapur për të dëgjuar dhe pranuar argumentet ndryshe dhe mbështetet në arsye, nuk insiston me çdo kusht në qëndrimet e tij. Njeriu i tillë nuk mendon për shfrytëzim të forcës dhe dhunës. Ndërsa personat që nuk janë të gatshëm për dialog, nuk e pranojnë dialogun, pasi janë të bindur se e dinë të vërtetën dhe se nuk kanë nevojë për kurrfarë bisede dhe argumente shtesë. “Janë

⁶ Po aty, f. 342;

⁷ Andrew Heywood “POLITIKA”, botimi i dytë, Botues: Botimet DUDAJ, Tiranë, 2008, f. 101;

⁸ “ENCIKLOPEDIJA DRUŠTVENIH NAUKA”, TOM 1 (A-M)/ priredili Adam Kuper i Džesika Kuper, Izdavač SLUŽBENI GLASNIK, Beograd, 2009, f. 117;

të kufizuar dhe të marrë, ndërkaq nëse vijnë deri tek pushteti politik - janë të rrezikshëm dhe të dëmshëm”⁹ dhe si zakonisht “Vetëkënaqësia gjithmonë është e përcjellur me marrëzi”.¹⁰

Në jetë dhe politikë, sikur të mos kishte dallime, nuk do të kishte nevojë as për dialog. Pra, mund konkludohet se nuk ka dialog pa dallime, por edhe pa sinqeritet. Në dialog është i nevojshëm respektimi i qëndrimeve vetanake, por edhe qëndrimi i palës tjetër dialoguese. Dialogu politik është shumë i rëndësishëm dhe luan rol stabilizues në shoqëritë me divergjenca të theksuara, pasi shpesh këto shoqëri nga dalogimi i suksesshëm i evitojnë edhe konfliktet shoqërore të llojeve të ndryshme, që potencialisht mund të jenë shkatërruese.

Dialogu nuk mund të ekzistojë aty ku nuk kemi matje të së vërtetës me ballafaqim argumentesh, por fuqia e luan rolin e “së vërtetës”, ku vendimet politike sillen në qarqet e ngushta të elitave politike e jo në mënyrë transparente. Dialog politik gjithashtu nuk ka aty ku “qytetarët shndërrohen në masë; ku nuk ekziston bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe ku nuk i lidhin vlerat universale: liria, barazia, solidariteti, miqësia, dashuria; ku nxiten konflikte nacionale, fetare, racore klasore dhe konflikte tjera; ku politikanët e shfrytëzojnë të drejtën për gabime (e drejta për gabime në politikë nuk ekziston - ai që gabon, patjetër të përgjigjet); ku politikanët manipulojnë me qytetarët; ku politikanët me propagandë përhapin ndjenja të këqija (xhelozia, urrejtje, zemërngushtësi) dhe gjendje të këqija (frikë, droje, panik, mashtrim)”.¹¹

Dialogu nuk mund të ekzistojë në jetën politike ku degradohet e bastardohet komunikimi, fjalët dhe gjuha shndërrohen në belbëzim demagogjik dhe pas fjalëve të folura nuk qëndron sinqeriteti, domethënia dhe veprat konkrete, por vetëm mashtrime, intriga dhe gënjeshtria. Dialogu kërkon që në diskursin politik, aty ku jepen premtimet të mos jenë “të zbrazëta”. Premtimet jepen (sidomos gjatë fushatave), ndërsa më vonë “harrohen” e nuk realizohen. Dialogu politik funksional është atribut i bashkësisë politike të emancipuar në çdo aspekt. Në një bashkësi politike ku të gjithë përnjëherë flasin, kurse askush askënd nuk e dëgjon, nuk ka dialog. Dialogu, gjithashtu, nuk mund të ekzistojë aty ku ka sundues dhe të sunduar, shtypës dhe të shtypur. Dialog nuk është “komunikimi” në mes të fuqishmëve dhe të pafuqishmëve. Në ato

⁹ Dr Čedomir Čupić POLITIČKA KULTURA I MEDIJI, FPN | Godišnjak 2009 | II DEO: Novinarstvo, komunikologija, kulturologija; str. 339-351; Beograd, 2009, f. 342;

¹⁰ Po aty. f. 342;

¹¹ Po aty. f. 342;

shoqëri edhe ku vetëm bisedohet dhe nuk udhëhiqet dialog, por më së shpeshti fjalën e kanë “shkathtësitë” (në kuptimin negativ), mashtrimet, intrigat dhe gënjeshttrat, aty thjesht ka “bisedë” në mes të pabarabartëve dhe aty nuk ka dialog, por ka improvizim dialogu.

Ku nuk ka partner të barabartë nuk ka dialog, pasi në esencën e bisedave nuk qëndrojnë argumentet, por fuqia. Ndërsa në politikë, me fuqi nuk *bisedohet*, por vetëm *negociohet*. Është dallim i madh dhe esencial në mes të bisedave dhe negociatave. Të negociosh, nuk është e njëjtë sikur të bisedosh. Aty ku në politikë premtohet, kurse premtimi nuk është obligues për palën që premtton, nuk ekziston dialog.

Dialogu është pjesë e një kulture më të gjerë politike dhe kulture të përgjithshme. Që të formohet kultura politike e dialogut, është e nevojshme që të ngrihet niveli i përgjithshëm i kulturës së qytetarëve, të ndërtohet besimi në mes të qytetarëve shpesh të ndarë në grupacione të ndryshme dhe me motive e interesa të ndryshme. Po ashtu, është e domosdoshme të krijohet ndjenja e sigurisë së ndërsjellë dhe besimit në mes të klasës politike, institucioneve dhe qytetarëve. Dialogu kërkon përgjegjësi për fjalën e thënë publikisht.

2. Kushtet për udhëheqjen e dialogut politik

Dialogu ekziston atëherë kur palët pranojnë të bisedojnë pa kushte dhe nga pozita e të barabartëve. Nëse nuk plotësohen parametrat e barazisë, atëherë nuk mund të kemi dialog, por “monolog” (“*bisedë më vetveten*”). Ofendimet, akuzat dhe fjalori joadekuat, janë e kundërta e dialogut politik dhe shumë shpesh komunikimet dhe akuzat e rënda nga subjektet politike dhe institucionale barten dhe shndërrohen në pjesë të përditshme dhe të përgjithshme të kulturës së komunikimit. Hapësira e komunikimit publik shpesh ngjan në arenë “gladiatorësh”, kurse akoma më tepër situatën e komplikojnë edhe rrjetet sociale, të cilat janë “jashtë kontrollit” dhe nuk kanë përgjegjësi për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së dialogimit në shoqëri. Por, fjalor jo të zgjedhur shpesh hasim edhe në konferencat zyrtare dhe komunikimin e ndërsjellë të subjekteve politike.

Dialog nuk mund të ketë në regjimet diktatoriale, pasi “Diktatura në kuptimin e ngushtë, është një formë sundimi, ku pushteti absolut qëndron te një individ. Në këtë kuptim, diktatura është sinonim i autokracisë”¹². Nuk ka dialog as në huntat ushtarake.

¹² Andrew Heywood “POLITIKA”, botimi i dytë, Botues: Botimet DUDAJ, Tiranë, 2008, f. 403;

Kushti i parë për dialog politik është **sinqeriteti** i palëve pjesëmarrëse në dialog. Nuk mjafton vetëm të deklarohet se janë për dialog, por duhet që edhe sjellja dhe veprimet të garantojnë gatishmëri për dialog. Nëse dy palët nuk janë të gatshëm, atëherë nuk ka dialog, pasi njëra palë nuk mund “të bëjë dialog me vetveten”.

Biseda e sinqertë në mes të palëve është parakusht për të fituar besimin ndërmjet palëve dhe ofron mundësi për pajtim dhe gjetje zgjidhje edhe për konfliktet të cilat në pamje të parë duken të pazgjidhshme. Kjo është pikënisja nga e cila politika nisët në ndërtimin e paqes dhe mirëqenies njerëzore.

Kusht tjetër për dialog në politikë është **barazia** (edhe kur bashkëbiseduesit nuk janë të barabartë për shkak të nivelit të arsimimit, përvojës jetësore, pozitës politike, duhet që pala më e zhvilluar të lëshohet në nivelin e të pazhvilluarit dhe me durim në bisedë ta ngrejë në nivel më të lartë); *kujdesi* (në veçanti të trajnohet durimi që të dëgjohet tjetri dhe të mos i ndërhyjë në fjalë); *respekti* (të mënjanohej fjalët ofenduese dhe përlulëse ose qëndrimet dhe gjestet ofenduese); *ndjenja e turpits* (kur thuhet diçka që mund të nxisë domethënie dhe shpjegime të ndryshme, të cilat bashkëbiseduesin pa qëllim mund ta lëndojnë); *argumenti më i mirë* (në bisedë i shkëmbejmë argumentet e në fund kur përfundojmë ose e përgatisim vendimin, e pranojmë argumentin më të mirë - atë të cilin asnjë nga bashkëbiseduesit në moment nuk mund ta mohojë) dhe *toleranca*.¹³

Kushti i dytë për dialog politik është **toleranca**. Fjala *tolerancë* vjen nga fjala latine që d.m.th: durim. Pra, toleranca nënkupton veprim të dyfishtë:

- e para, durim ndaj mendimit, pikëpamjes, bindjes, veprimit dhe sjelljes ndryshe nga e jotja;
- e dyta; pranimi dhe respektimi i dallimeve të bashkëbiseduesit tjetër.

Në **domethënien e parë**, tolerancë është **bartja e përbashkët e pasojave dhe dëmit**, që nënkupton tërheqje nga realizimi i një pjese të nevojave, interesave, pikëpamjeve dhe bindjeve personale. Toleranca është parakusht për kompromis. Në këtë kuptim, toleranca është fitore mbi egoizmin dhe bazohet në sakrificën. Është virtyt i njeriut apo më

¹³ Dr Čedomir Čupić POLITIČKA KULTURA I MEDIJI, FPN | Godišnjak 2009 | II DEO: Novinarstvo, komunikologija, kulturologija; str. 339-351; Beograd, 2009, f. 343;

tepër personave të cilët janë të gatshëm të sakrifikojnë diçka personale, për të gjetur zgjidhje dhe për të tejkaluar konfliktin.

Në kuptimin e dytë, toleranca nënkupton pranimin e dallimeve në mendime, ide, bindje dhe interesa. Toleranca na mundëson të kuptojmë se dallimet janë pjesë e jetës dhe jeta është e pamundshme pa divergjenca dhe se pikërisht divergjencat na shtojnë drejt zhvillimit.

Vetëdijesimi i shoqërisë njerëzore për tolerancën ndaj dallimeve, na e bën të mundur të kuptojmë edhe natyrën e **pluralizmit politik**, që nënkupton **dallim në mendime, interesa, ide, konstatime, bindje dhe veprime**. Dallimet, në ndërgjegjen e njeriut tolerant, kuptohen si diçka e natyrshme e normale.

Por, toleranca nuk nënkupton **neutralitet** shpirtëror ndaj problemeve shoqërore, e as **injoinim** të atyre problemeve, por nënkupton një gjendje shpirtërore dhe vetëdije njerëzore më të ngritur.

Subjekte të tolerancës mund të jenë individët, grupet dhe bashkësitë, por jo edhe shteti. Pasi shteti është sinonim dhe zbatues i normave kushtetuese e ligjore dhe i ruajtjes së rendit publik. Shteti nuk mund të jetë tolerant për atë çka është i obliguar ta respektojë e zbatojë, pasi është i autorizuar dhe në mënyrë legjitime disponon me forcën dhe sipas nevojës e përdorë atë, prandaj vetë shteti duhet të jetë garant i tolerancës. Toleranca vlen për pikëpamjet dhe bindjet ndryshe, por nuk vlen për mosrespektimin e normave ligjore dhe kushtetuese të aprovuara me pëlqimin e të gjithëve apo shumicës së qytetarëve. Toleranca gjithashtu nuk mund të pranohet vetëm në rastet kur në emër të lirisë vendohet në pikëpyetje liria e tjetrit dhe tjerëve. Nëse ndodh që në situatat specifike edhe shteti të jetë tolerant, kjo nuk mund të bëhet duke i shkelur normat ligjore, por duke i ndryshuar, avancuar dhe duke ia adaptuar realitetit të krijuar. Tolerancë as ligjore e as shoqërore nuk mund të ketë as ndaj dhunës që mund të ushtrojnë individë apo grupe të caktuara ndaj shoqërisë për interesa të ngushta.

3. Roli i dialogut politik në shoqëritë demokratike

Qeverisja demokratike përmban në vete edhe dialogun, debatin, argumentimin dhe arsyetimin e çështjeve të rëndësishme për shoqërinë dhe politikën, dhe me qëllim të sjelljes së vendimeve sa më optimale. Gjatë debateve në demokraci, deri tek vendimet arrihet në bazë të ideve, informatave e argumenteve, e jo mbi bazë të detyrimit me dhunë dhe përdorimit të forcës. Në procesin e dialogimit, palët e dëgjojnë dhe respektojnë njëri tjetrin. Me dialog zgjidhen mosmarrëveshjet dhe

kontestet, përafrohen qëndrimet dhe në fund arrihen marrëveshjet për temat që janë pjesë e kontestit. Vendimet e përbashkëta që dalin si rezultat i dialogimit ndërmjet palëve, duhet të jenë në harmoni me interesat, prioritetet dhe vlerat e qytetarëve. Dialogu si i tillë është mjet i cili e rrit participimin politik qytetar dhe legjitimitetin e vendimeve. Përparesia e dialogimit është në nacionalitetin e saj, gatishmëria për të dëgjuar e kuptuar drejt të tjerët, për të pranuar argumentet dhe marrëveshjen si zgjedhje përfundimtare (mund të ndodh edhe të përkohshme) të ndërsjellë.

Dialogu është si “oksigjen” për demokracinë dhe konsultimet e nevojshme në fazën e formulimit dhe të zbatimit të politikave. Shpesh ekziston mospajtim i theksuar për interesat dhe pikëpamjet e palëve në dialog. Përfshirja sa më e gjerë në vendimet që janë konform interesave, normave dhe vlerave të shoqërisë dhe normave kushtetuese e ligjore të shtetit, ndikon pozitivisht që edhe vendimet më lehtë të pranohen dhe të zbatohen. Pra, sa më tepër që kultivohet dialogu politik, aq më tepër ka gjasa që vendimet e miratuara të jenë në përputhje me vlerat dhe idealet e shoqërisë. Duhet dialoguar edhe kur argumentet janë diametralisht të kundërta. Dialogu dhe standardet e dialogimit në shoqëri mundësojnë që qytetari në interes publik të participojë më tepër në vendimmarrje, të jetë më i angazhuar dhe t’i mundësojë opinionit më të gjërë të ketë më tepër informata, por dhe vendimet të jenë sa më konsensusale dhe me përfshirje sa më të gjerë, që mund të vijë edhe tek shprehja e vullnetit politik kolektiv të shoqërisë, siç janë rereferendumet, plebishitet, etj.

4. Efekti i dialogut politik në funksionimin e demokracisë

Nuk ka sistem politik demokratik dhe demokraci të zhvilluar pa kulturë politike demokratike, ndërkaq kultura politike aspak nuk mund të mendohet pa dialog dhe tolerancë. Prandaj është e domosdoshme që pjesë e rregullimit politik demokratik të jetë edhe kultura e dialogut. Ky është një proces i dyanshëm dhe ashtu siç toleranca dhe dialogu mundësojnë vendosjen e rendit politiko-kushtetues demokratik, po ashtu edhe ai rend duhet ta shfrytëzojë tolerancën në mënyrë që ta lartësojë cilësinë e jetës së qytetarëve.

Që të krijohet vetëdija për rëndësinë e tolerancës si mjet për anulimin e konflikteve dhe përkrahjes së lirisë dhe jetës, është e nevojshme që tek individët të ndërtohet **kultura e dialogimit permanent**. Pasi dialogu mundëson tolerancën ndaj mendimeve të ndryshme, mundëson

sjelljen e vendimeve sa më kompetente, pamundëson sjelljen e papërgjegjshme të shtresave të caktuara të shoqërisë, dhe përfundimisht mënjanon konfliktet e llojllojshme në shoqëri. Njeriun dialogu e përgatit për durim dhe vendime të arsyeshme dhe me legjitimitet, sidomos tek vendimet politike. Njeriu i kultivuar për respektimin e vlerave të ndryshme, ka pikëpamje më kompetente, mendon e vepron me arsye, me logjikë dhe tolerancë. Ai është i përgatitur që ta dëgjojë tjetrin me kujdes edhe kur ka mendim ndryshe dhe të pranojë edhe argumentet e tjetrit, qoftë edhe sikur të jetë rival i tij. Diturinë dhe përvojën e tij nuk e konsideron si të vetmen dhe të pagabuarën. Vetëdija e tij është e hapur, e jo e mbyllur dhe me pikëpamje ekstreme. Dhe duhet cekur se vetëdija e mbyllur është përjashtuese dhe me orientim drejt ekstremizmit dhe fanatizmave të llojeve të ndryshme.

Në kushtet bashkëkohore, toleranca më nuk duhet të merret si **mjet i durimit**, por si mjet me ndihmën e të cilin **pranohen dallimet dhe pasurohet jeta**.¹⁴

Dialogu dhe toleranca në jetën bashkëkohore, e sidomos në politikë, në vete përmbajnë besimin dhe shpresën se mund të jetohet në paqe, në mirëkuptim dhe në mënyrë të qetë.

Duhet theksuar se në jetën politike të një shoqërie dhe shteti mjet i rëndësishëm është *kompromisi* (bashkëpunimi), që buron nga dialogu politik. Pra, aty ku është mundësuar liria e mendimit, të shprehurit dhe të organizimit politik me ide dhe pikëpamje të ndryshme, dialogu është determinantë mjaft e rëndësishme e politikbërjes dhe vendimet shpesh janë rezultati i procesit të dialogimit, që si epilog zakonisht kanë kompromiset. Por, kompromisi si i tillë nuk është i mundshëm në çdo sferë dhe në çdo pore të shoqërisë, por është e kufizuar në sfera të caktuara. Pra, nuk mund të kemi kompromis gjithkund, si p.sh. ndërmjet të mirës dhe të keqes, të vërtetës dhe gënjeshtërs, krimi dhe humanizmit, të moralshmes dhe të pamoralshmes, drejtësisë dhe padrejtësisë, etj.

KOMPROMISI zakonisht përdoret në politikë në vendim-marrje me qëllim që të evitohen tërësisht ose të zvogëlohen konfliktet. Qeverisja demokratike e shfrytëzon në maksimum kompromisin. Prandaj **kompromisi** është i rëndësishëm si filozofi politike dhe si standard

¹⁴ Dr Čedomir Čupić POLITIČKA KULTURA I MEDIJI, FPN | Godišnjak 2009 | II DEO: Novinarstvo, komunikologija, kulturologija; str. 339-351; Beograd, 2009; f. 344.

në vendimmarrjen politike. “Kompromisi arrihet në mes të dy të drejtave ose dy të mirave - në matjen e forcave do ta pranojmë ose zgjidhjen e mesme ose atë që për momentin është më mirë e argumentuar”.¹⁵

Dialogu politik si pjesë e **kulturës politike demokratike as që mund të paramendohet pa konsensusi-n**, gjegjësisht **pëlqimin e të gjithëve**. Vendimet më të mira në jetën e përbashkët janë ato që arrihen me pëlqimin e të gjitha grupeve të interesit. Konsensusi politik mundëson që të gjithë pjesëmarrësit në vendimmarrjen politike të pajtohen, ku asnjë nuk është i mbivotuar dhe asnjë nuk ka ndjenjë se është i mashtruar ose i fituar. Konsensusi sidomos është shumë i rëndësishëm në procesin e sjelljes së vendimeve më të rëndësishme politike, në veçanti në shtetet shumë nacionale dhe shumë religjioze. “Imponimi i vullnetit të shumicës ndaj pakicës, mund të jetë shkak i konflikteve të papajtueshme dhe të rënda. Pikërisht konsensusi në shtetet e tilla mundëson që pakicat nacionale, religjioze ose cilat do qoftë pakica, të ndjehen të barabartë dhe jo të lënë pas dore.”¹⁶

Kritika zakonisht nënkupton ballafaqim të arsyeshëm e racional dhe të argumentuar të qëndrimeve për ndonjë koncepcion, problem e ide. Kritika zakonisht është efektive nëse është këmbëngulëse dhe si e tillë mundëson zgjidhje më të mirë për problemet e ndryshme shoqërore dhe sjelljen e vendimeve të qëlluara.

Kritika në veçanti është e dobishme për jetën institucionale dhe politike. Sepse politika pa kritikë jo që është e rrezikshme, por edhe shkatërruese. Kritika ndihmon dhe e pamundëson që pushteti të përfundojë në keqpërdorim, abuzim, si sistem autoritar apo diktaturë. Pushteti demokratik, kritikët dhe kritikën e argumentuara i ka aleat të fuqishëm që e mbrojnë nga gabimet gjatë qeverisjes. Pa kritikë, pushteti lehtësisht përfundon në jotransparencë e autokraci, në gjendje të pa perspektivë dhe shumë shpesh me konflikte shoqërore e politike.

Kontrolli ndaj pushteti i pengon paligjshmëritë, uzurpimet e keqpërdorimet dhe e nxit efikasitetin. Sa më tepër mekanizma kontrolli që ka shoqëria ndaj pushtetit, aq më e vogël është mundësia për ta keqpërdorur atë, ose për të përfunduar në sistem jodemokratik.

Rëndësia, roli i dialogut politik është mjaft i madh edhe kur është në pyetje formimi dhe ngritja e koalicioneve zgjedhore, paszgjedhore, qeveritare, etj. Nuk ka asnjë dilemë se të gjitha llojet e koalicioneve politike janë “produkt” i dialogut politik, me të cilin palët i

¹⁵ Po aty. f. 345;

¹⁶ Po aty. f. 345;

“hekurosin” dallimet, harmonizojnë interesat, ndërtojnë strategji të veprimit qeveritar ose opozitar, etj.

Shembull i një dialogu të suksesshëm janë formimet e koalicioneve politike, e sidomos **koalicioneve të mëdha politike**.

“Qeveria e koalicionit të madh është **mjet konsociativ** burimor, por edhe forma tjera të ndryshme mund t’i shërbejnë qëllimit të njëjtë. Karakteristika themelore e **koalicionit të madh nuk qëndron në ndonjë harmonizim të caktuar institucional, por në pjesëmarrjen e udhëheqësve të të gjitha segmenteve të rëndësishme në qeverisjen me shoqëritë plurale**”.¹⁷

Por dialog akoma më i nevojshëm është për modelin e **shoqërive konsociative** dhe në “Në shoqëritë pluraliste ku mbahen zgjedhjet e lira, përçarjet e theksuara të shoqërisë zakonisht barten në sistem partiak; partitë politike gjithmonë janë manifestime politike të organizuara të segmenteve. Ekzistimi i partive të tilla **është i favorshëm për demokracinë konsociative**. Ata paraqiten si përfaqësues politik të të gjitha segmenteve, kurse sigurojnë mënyrë të mirë për zgjedhjen e udhëheqësve të segmenteve të cilët do të marrin pjesë në koalicionet e mëdha”.¹⁸

Conclusion

It is very clear that dialogue as a way of thinking, behavior and social and political action, in modern societies and in modern politics, especially in developed democracies, is always more and more necessary and present. Modern states and democracies, but also the functioning of political parties, trade unions and other social and social factors can not function without dialogue. Based on the above, we conclude that **dialogue is permanently necessary for political and institutional decision making** because:

- **First**; Through dialogue, political decision-making is easier and decisions have broader support in society, respectively they are more legitimate;

- **The second**; Implementing the decisions made is also easier, more efficient and more successful;

- **The third**; Through dialogue many conflicts of different kinds within society and state, but also between states, are often prevented; and

¹⁷ AREND LJIPHARD “Demokracija u pluralnim društva”, Izdavači: GLOBUS, Nakladni zavod, Zagreb i ŠKOLSKA KNJIGA Zagreb, 1992; str. 38.

¹⁸Po aty, f. 67.

-Fourth; Political dialogue, along with freedom of expression, freedom of organization, political communication, compromise, tolerance, consensus, criticism and control of institutions, is one of the main pillars on which democracy can be built and functioning.

And as a result we conclude that:

- **Modern societies** have a social, political and human **imperative** to create and cultivate political culture and standards of sincere, just and effective dialogue and communication;

Dialogue and compromise must necessarily be **part of the political, permanent, policy-making policy, political decision-making process and the education strategy of young generations for orientation towards social and political dialogue as a permanent orientation of political culture and democratic governance of society.**

Recensentë:

Prof. dr. Fatmire Lumani

Prof. dr. Mersim Maksuti

BIBLIOGRAFIA:

1. W.Phillips Shiveley “Hyrje në Shkencat Politike“, Botues AIIS, Tiranë , 2012.
2. Andrew Heywood “ POLITIKA“, botimi i dytë, Botues: Botimet DUDAJ, Tiranë, 2008.
3. Anthony Giddens “SOCOLOGJIA“, Botues: Botime Çabej, Tiranë, 2004.
4. Ralf Darhendorf “Konflikti shoqëror modern“ (Ese për politikën e lirisë), Botues DITURIA-CEU, Budapest, 1997.
5. “ENCIKLOPEDIJA DRUŠTVENIH NAUKA“, TOM 1 (A-M)/ priredili Adam Kuper i Džesika Kuper, Izdavač SLUŽBENI GLASNIK,Beograd, 2009.
6. “ENCIKLOPEDIJA DRUŠTVENIH NAUKA“, TOM 2 (N-Ž)/ priredili Adam Kuper i Džesika Kuper, Izdavač SLUŽBENI GLASNIK,Beograd, 2009.
7. AREND LJIPHARD “Demokracija u pluralnim društvima“, Izdavači: GLOBUS, Nakladni zavod, Zagreb i ŠKOLSKA KNJIGA Zagreb, 1992.
8. J. J. CHEVALLIER, Y. GUCHET “VEPRAT E MËDHA POLITIKE” , Botues LIRA, Tiranë, 2001.

9. Милан Вујаклија “ЛЕКСИКОН СТРАНИХ РЕЧИ И ИЗРАЗА“, ПРОСВЕТА, БЕОГРАД, 1992;
10. ARISTOTELIS “POLITIKA“, Botues Plejad, Tiranë, 2003.
11. Max Weber “POLITIKA SI PROFESION“, Botues ASDREDNI, Shkup, 2009.
12. KLAUS VON BEYME “SUVREMENE POLITIČKE TEORIJE“, Izdavač STVARNOST, Zagreb, 1974.
13. Manfred G. Schmidt “TEORITË E DEMOKRACISË“ (botim universitar), Botues BOTART, Tiranë, 2012.
14. Dr.Toma Đorđević “POLITIČKO JAVNO MNENJE“, drugo dopunjeno izdanje, Beograd, 1989.
15. Toma Đorđević “KOMUNIKACIJA I VLAST“, VELIKA EDICIJA “IDEJA“, Izdavač “MLADOST“, Beograd, 1988.
16. Slaviša Orlović “POLITIKOLOŠKI OGLEDI“, Izdavač “SLUŽBEN GLASNIK“, Beograd, 2010.
17. Čedomir Čupić “POLITIKA I ZLO“, ČIGOJA ŠTAMPA, Beograd, 2001;
18. Vojislav Stanovčić “VLAST I SLOBODA“, ČIGOJA ŠTAMPA, Beograd, 2003;
19. Vukašin Pavlović “DRUŠTVENI POKRETI I PROMENE“, 3.izd., Službeni glasnik: Zavod za udžbenike Beograd, 2009;
20. HANNAH ARENDT “ORIGJINAT E TOTALITARIZMIT“, Botues DIJA, Prishtinë, 2002;
21. Slaviša Orlović “PARTIJE I PARTIJSKI SISTEMI“ (Teorijski-analitički okvir), Izdavač Univerzitet u Beogradu Fakultet političkih nauka, Beograd, 2015.
22. DANIEL –LOUIS SEILER “PARTITË POLITIKE“, Botues UET Press, Tiranë, 2000.
23. Sammuell Enoch Stumpf “FILOZOPIA“ (Historia & Problemet), Botues: Botime Toena, Tiranë.
24. Toma Đorđević “TEORIJA INFORMACIJA/TEORIJA MASOVNIH KOMUNIKACIJA“ Izdavač IRO “PARTIZANSKA KNJIGA“ -Ljubljana, OOUR “ Izdavačko-publicistička delatnost “Beograd, 1979.
25. HANNAH ARENDT “NDËRMJET TË SHKUARËS DHE TË ARDHMES“, Botues CEU PRESS Onufri, Tiranë, 1998;
26. Dr Čedomir Čupić POLITIČKA KULTURA I MEDIJI, FPN | Godišnjak 2009 | II DEO: Novinarstvo, komunikologija, kulturologija; str.339-351; Beograd, 2009;

27. Miloš Ilić “SOCIOLOGIJA KULTURE I UMETNOSTI”,
Izdavač: Naučna knjiga; BEOGRAD, 1987.

28. Đuro Šušnjić “RIBARI LJUDSKIH DUŠA“ (ideja manipu-
lacije i manipulacija idejama); Izdavač: NIRO “MLADOST“, Beograd,
1990.

Burime nga interneti:

1. <http://www.enciklopedija.hr/natuknica.aspx?id=49235>